

Aktet për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik

Ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Të detyrueshme për konsultim janë:

- buxheti dhe ndryshmet e tij (programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore)
- taksat e tarifat vendore
- tjetërsimi ose dhënia në përdorim të pronave të tretëve
- rregullorja e brendshme e funksionimit të këshillit të bashkisë
- normat, standardet dhe kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve të këshillit të bashkisë që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimitin e interesit publik.